

# S T A T U T I

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "GEOID STUDIO " SH.P.K.



*Dt. 16.01.2018*

### **KAPITULLI I** **Emërtimi - Selia - Jetëgjatësia**

#### **Neni 1 - Themelimi**

Është krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "**GEOID STUDIO**" Sh.p.k. mbi bazën e aktit të themelimit.

#### **Neni 2 - Selia**

Shoqëria e ka selinë ligjore në L. "Kastriot", Fier, Rr. "Rrapi Toska"; Hyrja nr. 1, Ap. 3, me nr. Pas. 5/40+1-3, ZK.8534.

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë këtij territori, duke hapur zyra apo degëve ose nëpërmjet veprimtarive të kryera në përputhje me misionin dhe statutin e shoqërisë si dhe legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 3 – Kohëzgjatja**

Afati i veprimtarise se saj do te jete me një afat kohor te pacaktuar.

### **KAPITULLI II**

#### **Objekti**

#### **Neni 4-Objekti e qëllimet shoqërore**

- Projektimin e punimeve inxhinierike e topografike
- Pergatitje te Planimetrike; planeve te rilevimit; Akteve te ekspertimit;
- Rilevime topografike
- Punime topografike
- Piketime inxhinierike
- Projekte elektrike
- Vleresime pasurie
- Projekte Arkitektonike
- Projekte hidroteknike
- Vleresim i ndikimit ne mjedis
- Projekte per mbrojtjen nga zjarri
- Konstruksione; Konsulencë ne lidhje me pasurite e paluajtshme
- Ndermjetesim
- Punime hartografike dhe fotogrametrike
- Imobiliare
- Zbatim punimesh inxhinierike
- Supervizim dhe kolaudim objektesh , etj.

Për realizimin e qëllimit te saj shoqëria mund te bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik ne çdo mënyrë që e gjykon te dobishme.

Shoqëria ne çdo kohe mund te ripërcaktojë objektin e saj, ta shtoje apo pakësojë atë, me

vendim te ortakut te vetem.

### KAPITULLI III Kapitali shoqëror-Kuotat

#### Neni 5 -Kapitali shoqëror

  
Kapitali shoqëror fillestar është 1 000 lekë (një mijë leke).

Kapitali i shoqerise krijohet me mjetet financiare prona e ortakut te vetem ku ortaku i vetem zoteron 100 % te kapitalit ne shumen 1 000 leke (një mijë leke) e shprehur ne një kuote.

#### Neni 6-E drejta e pronsisë

Posedimi qoftë edhe i një kuote përbën në vetvehte pranimin e aktit të themelimit dhe të këtij statuti.

#### Neni 7-Trasferimi i kuotave

Kapitali themeltar I ortakut te vetem eshte lirisht I transferueshem ne rruge trashegimie . Me vullnetin dhe vendimin e ortakut te vetem kapitali themeltar mund t'I transferohet edhe personave te trete sipas formes se parashikuar ne ligj .

### KAPITULLI IV

#### Marrja e vendimeve, Administrimi, Kompetencat dhe Kontrolli i Shoqerise

#### Neni 8

Ortaku I vetem ushtron gjithe kompetencat qe ligji 7638 I ka dhene Asamblese se Shoqerise me perjegjesi te kufizuar . Vendimet e ortakut te vetem jane te detyrueshme per administratorin dhe punemarresit kur ato jane marre konform ligjit dhe statutit .

#### Neni 9


**Ortaku I vetem** vendos vete kryesisht per keto ceshtje:

- Përcaktimin e politikave tregtare
- Merr vendime per ndryshimin e formes, emertimit, selise, kapitalit, veprimtarise se shoqerise, ndryshimin ne zoterimin e kuotave te kapitalit te shoqerise, pranim te ortakeve, pjesemarrjen e shoqerise ne shoqeri te tjera dhe anasjelltas, per ndryshimet ne Statut.
- Miraton raportet financiare dhe bilancin vjetor, vendos per perdonimin e fitimit, organizimin e shoqerise dhe per prishjen e saj.
- Emerton dhe shkarkon administratorin, likuidatorin, ekspertet kontabel si dhe drejton veprimtarite e rendesishme te shoqerise.

Marrja e vendimeve realizohet me iniciativen e ortakut te vetem ose me kerkese te administratorit, te ekspertit kontabel te cilet ne kete rast duhet t'i njoftojne ortakut projektin dhe relacionin shpjegues 15 dite perpara takimit.

#### Neni 10 -Administrimi

Emërimi i Administratorit te shoqërisë është kompetence e Ortakut te Vetem.



## **Administrator i shoqërisë do te jetë z. Alban Suku.**

Administratori i shoqërisë ka te drejte te ushtroje detyrat dhe kompetencat e mëposhtme:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare ne maredhenie me te tretet;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, përt'u paraqitur më pas për miratim nga Ortaku i vetem;
- d) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rr Ethanat, që kërcenojnë ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
- e) të raportojë përparrë asamblesë për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
- ë) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

## **Neni 11-Delegimi i fuqive (kompetencave)**

Administratori mund t'i delegojë atributet e tij, duke përcaktuar caqet e delegimit:

- një Drejtori të Përgjithshëm ose komercial.

## **Neni 12-Kompetencat e Organit Administrativ**

Administratorit i takojnë keto kompetencia:

- fuqitë (të drejtat) për administrimin e aktivitetit të shoqërisë dhe për përbushjen më së miri të objektit shoqëror;
- mbikqyrjen e kontrollin e aktivitetit e të pasurisë së shoqërisë, me të drejtën e kryerjes së të gjitha operacioneve dhe akteve që çmohen të nevojshme për përbushjen e objektit shoqëror brenda caqeve të përcaktuara nga Asambleja, duke përjashtuar vetëm ato që ligji e statuti ja rezervojnë Ortakut te Vetem.
- përfaqësujë shoqërinë para të tretëve duke respektuar objektin shoqëror, autoritetet e gjyqsore, administrative e noteriale;
- fuqitë për organizimin e shoqërisë me të drejtën e krijimit e rregullimit të zyrave të ndryshme (përfshirë Drejtorë, teknikët e nëpunësit), duke përcaktuar funksionet e të drejtat, krijuar e suprimuar organe konsultative.

## **Neni 13-Përfaqsimi i shoqërisë**

Përfaqsimi i shoqërisë i përket në vijë të përgjithshme Administratorit te shoqerise.

Përfaqsimi i shoqërisë i përket gjithashtu:

-përfaqshesve të posaçëm, që mund të emërohen për akte apo kategori aktesh të veçanta, nga të gjithë subjektet e treguar në këtë nen, secili brenda të drejtave të tij.

## **Neni 14 - Shpërblimi i administratorëve**

Administratorit i përket kompèsim për shpenzimet e kryera për arsyen e zyrës si dhe një shpërblim, që mund t'ju përcaktohet nga Ortaku i Vetem me vendim të vlefshëm deri në ndryshimin e tij.

**KAPITULLI V**  
**Kontrolli i shoqërisë**



## **Neni 15 - Ekspertët kontabël të autorizuar**

Ortaku i vetem emëron në rastet e parashikuara nga neni 65, i Ligjit 7638 një apo disa ekspertë kontabël të autorizuar. Shpërblimi i tyre përcaktohet me vendim te ortakut te vetem.

## **KAPITULLI VI**

### **Bilanci**

## **Neni 16 - Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor mbylllet më 31 dhjetor të çdo viti.

## **Neni 17 - Bilanci**

Në fund të çdo viti organi administrativ merr masa në përputhje me urdhërimet e ligjit, për kryerjen e bilancit të shoqërisë.

## **Neni 18 – Fitimet**

Fitimet neto te realizuara nga veprimtaria e shoqerise,mbasi te jene zbritur te gjitha shpenzimet e kryera,I shperndahen ortakut ose me vendim te tij mund te perdoren per investime,nxitjen e veprimtarise tregetare, reklama dhe per cdo qellim tjeter te ligjshem dhe qe i sherben shoqerise.

## **KAPITULLI VII**

### **Dispozita të përgjithshme**

## **Neni 19 - Zgjidhja e likuidimi**

Aktiviteti pushon dhe shoqëria zgjidhet, kur:

- përfundon afati i kohëzgjatjes së vendosur;
- pamundësia për të mbuluar humbjet e shoqërisë nga ana e ortakut te vetem, në përputhje me kuotat shoqërore që posedon;
- në çdo rast me vendim të Ortakut te vetem që do të emërojë një ose më shumë likuidatorë duke fiksuar të drejtat e shpërblimin.

## **Neni 20 - Klauzola e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve**


Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë rreth vlefshmërisë, interpretimit dhe ekzekutimit të kësaj kontrate, do ti besohet vendimit të Gjykatës së vendit ku shoqëria ushtron aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 21- Referim**

Për gjithçka sa nuk është parashikuar zbatohen normat e Kodit Civil dhe ligjet e tjera të fushës përkatëse.

## **ORTAKU I VETEM**

*ALBAN SUKU*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISE- VLORE  
Nr. 136 rep.

**VERTETIM NENSHKRIMI**

Sot më datën 16.01.2018 (gjashtembedhjete janar dymije e tetembedhjete), para meje Noteres Entela Shqepa, anetare në Dhomën e Noterisë Vlore, u paraqit personalisht:

- **Alban Suku**, i danielindjes 24.05.1990, lindur ne Fier, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga unë noterja me Leternjoftimin numer 025903676, me numer personal J00524093B, I cili nënshkruan në prezencën time **Aktin e Themelimit dhe Statutin** e Shoqerise "**GEOID STUDIO**" Sh.p.k. , pasi deklaroit se e ka kuptuar mirë përbajtjen dhe unë noterja e vertetoj rregullisht konform ligjit.

NOTE R E  
Entela Shqepa



A handwritten signature in blue ink, reading 'Entela Shqepa', is written over the circular stamp.

